

*Permes nje xhami*

Michele Cènnamo

# Permes nje xhami

Perkthyer nga Vjola Myrto



Liber Iter  
edizioni elettroniche

*Permes nje xhami*

# *Permes*

## *nje xhami*

*nje histori dashurie ne vargje*

*nga Michele Cènnamo*

*Perkthyer nga Vjola Myrto*



Liber Iter  
edizioni elettroniche

## ***Michele Cènnamo***

Michele Cènnamo eshte gazetar dhe shkrimtar, korrespondent special i *Avvenire*, per te cilen momentalisht kuron rubriken ‘L’Italia che cresce’ (Italia qe rritet) ne edizioni on line te se perditshmes katolike.

Fillimet e tij ne gazetari datoje 1968 ne moshe shume te re, ndersa bashkepunimi me *Avvenire* paraprihet nga bashkepune te rendesishme me *Il Tempo*, *Momento Sera*, dhe *La Domenica del Corriere*.

Ne karrieren e tij si shkrimtar, gjejme publikimin e mbi njezet librave, disa prej te cileve te realizuar me bashkepunimin e Franco Vundo. Vepra e fundit e publikuar eshte **Bernadette e Lourdes**, nje histori e rindertuar mjeshterisht duke u bazuar ne dokumentat e ruajtura ne arkivin e vatikanit, e sjelle tek lexuesi ne forme romani.

*Permes nje xhami*

Krahas ketyre aktiviteteve, autori ka bashkuar edhe ate te poetit, disa prej veprave te tij jane publikuar ne kinezce dhe greqisht.

Jeton ne Milano, perzonazh rreshqites dhe i thjeshte si cdo poet, eshte ne dispozicion te kujtdo qe deshiron te kontaktoje me te per te folur per veprat e tij, apo thjesht t'i shprehi drejt per drejt opinionet personale.

Celular 347 4133183

## ***Hyrje***

Nuk ndodh shpesh ne nje shoqeri si e jona, imorale, plot me shtremberime dhe mizori, te gjejme hapesire per dashurine, per ndjenjen apo per pastertine e shpirtit.

Ne kete realitet te papranueshem, te publikojme apo te flasim per poezi mund te duket nje sforcim i pamase por kush tha qe dashuria po mbaron dhe qe po shnderrohem i ne robot pa shpirt, pa ate ndjenje qe gjithmone ka dalluar njeriun nga kafsha?

Ky vellim tregon te kunderten, duke qene se ne keto pak rreshta lexohet vuajtja e nje jete te tere, ndjenja e nje njeriu akoma gjalle, i forte dhe pershtelles me emocione asnjeherë te shuara.

Ndjeshmeria e Tij , ndonjehere edhe e maskuar per te mbijetuar, shfaqet dale nga dale sa here qe meson t'a njobesh dhe shpirti i femijes qe ndodhet ne cdo poet te vertete arrin, me fjale te thjeshta, te qelloje ne zemren e cdo

*Permes nje xhami*

kujt qe jeton apo deshiron te jetoje me ndjenja dashurie, te cdo kujt qe ka etje per fjale te perkthyera ne nje gjuhe hermetike por te mbushur me te verteta, te lodhur nga ngjarjet por gjithnje universale dhe e kuptueshme per te gjithe.

Michele Cènnamo ka perkthyer jetesen me dashuri, aty ku cdo njeri prej nesh mund te identifikoje veten, te kaloje momente jete, te analizuar hollesisht, duke na bindur qe eshte Poeti i fundit i brezit te tij.

Leonardo Echeoni

**D**o te kisha dashur te isha ndryshe  
ndoshta te hidhem ne nje zjarr,  
qe me pas te me modeloje dashuria  
krijim i mendjes tende.

**D**o te kisha dashur te te krijoja une,  
ndoshta duke vjedhur magjine e nje kohe,  
te shkuar,  
per te te shfaqur me pas shpirtin tim,  
kaq cigan.

**E** di qe e shkreta lulja ime e fuses,  
neser do te vdese,  
por frymemarrjen e fundit,  
do e kete nga goja jote.

**T**e imagjinoj ne gjysme hijen e dhomes tende  
dhe e di qe cdo nate do te me kerkosh,  
por shikimin e fundit  
do t'a dhurojne,  
syte e mi te trishte.

**K**ur ne qiejte e ngrysur,  
nje shqiponje do te shenoje sahatin tim,  
do te perkulesh koken tende te embel.

**K**ur fytyra ime e lodhur,  
ne ate pranvere te hidhur,  
do te vyshket,  
do te gjesh ne duart e tua,  
portin e saj te mbrritjes.

**D**o te me presesh,

*Permes nje xhami*

si nje rrefugjat dashurie,  
i projektuar  
ne kepin kalimtar te jetes,  
pergatitje e vdekjes sime.

**F**jale te hidhura do te shqiptosh,  
Dhe plequeria ime e parakohshme,  
do te jete konfuze,  
ne pluhurin e nje toke qe do te me mbuloje,  
perfundimisht te qete.

**S**yte e mbyllur,  
do te ruajne,  
si rifleks ekstrem,  
buzeqeshjen tende per kete jete te kote,  
ne kerkim,  
te nje rifuxhi te pa njohur

per mua,

i mbuluar nga nje dhimbje e argjendte.

**M**omente te nje iluzioni te embel,

qe mblodha,

midis gjetheve te rena,

te pemes,

te takimit tone te pare.

**F**jale bosh qe era te solli,

me lajmerimin,

e nje pritjeje te re,

ndersa do te kthehen hijet e se shkuares.

**K**reshma e bardhe

e deshires sime te fundit,

do te ledhatoje fytyren.

**H**ena e zbehte do te na buzeqeshi e qete,  
ne te dale te asaj taverne  
do te degjohen te bertiturat,  
e disa klienteve,  
te perzene nga nje hanxhiut te keq.

**N**e dendesine e shkurreve,  
te fshehur,  
do te rizbulojme  
nje uje burimi te kthjellet,  
qe do te preke  
token e zymte ne heshtje.

**T**e arratisesh larg,  
permes tokave te zemres tende,  
te hedhesh pas vetes,

hithrat e kujtimeve te tua.

**T**e harrosh dite,

te perbera me asgje,

te besosh ne nje histori,

te hidhur,

si perkedhelite e tua.

**T**e kapesh fjalet e kota,

me pas per te qare,

ndersa papritur,

do te thermohen ato endrra,

te diktuara nga shikimet e tua,

te dashurise.

**N**ese do te isha nje tjeter,

do te te shtrengojë

*Permes nje xhami*

pa te kerkuar asgje,

por,

koha e paepur,

me terheq me vete.

**D**okumenta qe shenojne,

sikletshem,

ne fletoren time te vjeter,

te gervishtur me lot.

**P**robleme,

qe lexova mbi fytyren tende,

ate mbremje,

pas qoshes se shkolles sime.

**F**jale qe shushuritjet e se sotmes,

do te fshijne,

*Permes nje xhami*

pa medyshje,  
nga mendja jote.

**I**mazhe,  
te nje momenti,  
qe ndaloi mbi buzet e mia,  
afer te tuave.

**N**e perjetesine e kohes  
drita e botes,  
do te pershtjelli fushat e fildishta,  
ne kishen e modeste,  
edhe pllaka me mbishkrim e sacrifices sime,  
do te perkulet,  
ngadale.

**N**je gjykates i paepur,

*Permes nje xhami*

do te konsideroje ate jete qe me dhurove,  
nje mengjes,  
te nje vjeshte kalimtare,  
ndersa rehatoheshim me avash,  
ne rrugen e shkrete,  
gjethet.

**D**o te jete mesazhi,  
i nje njeriu,  
qe uleret historine e tij,  
ne qetesine e nates,  
nje njerezimi,  
te mbyllur,  
nga nje indiference e perditshme.

**D**o te kyc,  
pas vetes,

*Permes nje xhami*

porten e dashurise tende,  
do te te le ne erresire,  
ne ate dhome,  
qe shume here na pa bashke,  
per t'u kthyer drejt paqes,  
se ireales.

**K**ur, me pas,  
nata do te te mbeshtjelli,  
embelsisht,  
ne heshtjen e kohes,  
mes luftes se dashurise,  
do rijetosh kujtimet  
qe kishe fshehur,  
ne thellesine e kujteses tende.

**V**uajtja e nje viti,

*Permes nje xhami*

kaluar ne pafundesine e hapesires,  
de te kene rrreth vetes,  
jehonen e nje frymemarrje tenden,  
ndersa do te alternohen  
imazhet e fytyres sime.

**K**onsiderimet e njerezve,  
ata te perditshmit,  
nuk do te lendojne me,  
do te kesh humbur momentin e fundit  
te lirise tende,  
do te mendosh per gjerat e mia,  
qe une te shushurisja,  
do t'i besosh perrallave te mrekullueshme,  
te jetes sime.

**A**tehere,

*Permes nje xhami*

do te kene flutuar larg  
ditet e lumturise time  
dhe hidherimi I se nesermes,  
do te te kete dhuruar,  
buzet e tij te vdekjes.

**D**o eci mbi reren  
me nje dobesi te vazhdueshme,  
per mos lene gjurme  
te kalimit tim,  
por nje fllad melankolik,  
do me ulerase shakane mizore,  
te nje deshire te pamundur.

**L**ejleku i fundit,  
nuk do te kthehet kurre me  
mbrapsht,

*Permes nje xhami*

ka fshehur pas vetes,  
deshiren per te jeutar,  
si mua.

**N**uk do te shohesh trishtimin,  
e veshtrimit tim,  
sepse do te injorosh,  
cdo moment  
te kohes sime.

**D**o refuzosh te mbledhesh  
ate lulen e terrte,  
qe nje toke e thate  
do te kete pjelle  
ne grumbullin e gureve mbi mua,  
por do te vravosh  
drejt hijes time,

*Permes nje xhami*

duke i fshehur vetes,  
ulerimat e dashurise,  
qe nuk mund te degjosh.

**P**yetje bosh,  
qe do mbeten,  
gjithmone,  
pa pergjigje,  
duke te mohuar rrugen e vetme  
te asaj drite antike,  
qe te con drejt asgjese se perjetshme,  
te se nesermes tende.

**D**o te me lesh,  
vetem,  
me trishtimin,  
e nisjes tende,

duke marre me vete,  
bagazhin e paepur  
te dhimbjes,  
vuajtjet e rinise time.

**N**e rrjedhen e lumi,  
guret e gerryer nga uji,  
do te jene aty,  
te palevizshem,  
te presin ardhjen tende.

**S**htrire mbi barin e njome,  
te mengjesit,  
do te filloj te fantazoj,  
pa nje arsyte te vertete.

**D**o te ndjek endrrat me sy hapur,

*Permes nje xhami*

do te te dua prane,  
ne iluzionin e nje te djeshme,  
tashme te sfumuar.

**M**agji e nje atmosfere,  
thuajse enderruese,  
por realiteti do te doje te jetë i pranishem,  
ne disfaten e luftes time.

**N**je perkedhelje e lehte  
mund te bej te harrojme,  
ato lule,  
qe dimri  
ka mbytur ne vetvete,  
por nuk do te celin kurre,  
ato margaritat e vogla,  
qe nje traktor i rende

shtypi ne fusha.

**A**tij qe do te te zgjas i doren,  
mos i moho me nje buzeqeshje tenden,  
ke mesuar jeten,  
permes loteve.

**R**ugja e bardhe,  
e shenuar me gisht,  
nga te moshuarit e fshatit,  
pergjate gardhit te takimit tone,  
sot,  
u ngjye me te kuqe, per gjakun tim.

**M**ormorimat e fundit  
ia ulerita vdekjes,  
doja te luftoja akoma,

*Permes nje xhami*

bashke

me shpresen kalimtare te kohes,

kimerat

e momentit fluturak

nuk do te shkelqejne me,

per te me shoqeruar

ne udhetimin e madh,

drejt botes se re.

**J**ehona

e nje kenge te larget,

do te kthehet dhunshem,

per te te shfaqur dhimbjen time te gjalle,

do te jene vetem

fjale te zbeheta.

**F**luturat e verdha

*Permes nje xhami*

te kujtimeve te tua,  
do te fluturojne lart,  
drejt qiellit,  
do te ul shikimin,  
i frikesuar  
per gjithshka dhe per asgje.

**N**e emer te dashurise,  
do te dua te shkepus,  
nga simbolet magjik te qenies,  
forcen  
te kthehem ne token time,  
ne te ftohtin e mbremjes,  
ndaj te erruri,  
edhe artizani i moshuar  
i mbyll deren me shul

melankonise se mendimeve te mia.

**T**e zhdukem keshtu,

pa i thene asgje miqve,

nenes,

gruas,

le largohem me te shkuaren,

te hidhem komplet brenda jetes,

duke lene canten e shpines,

ne depoziten e kujtimeve.

**T**e degjova te shushurisesh...

“Une nuk iki”

por nuk mundja te te ndiqja me

me sy.

**I**she mes njerezve,

*Permes nje xhami*

e permbytur  
nga rruget e nje qyteti te thate.

**E** gjeta veten,  
prane nje plazhi,  
qe ate mengjes,  
te nje nentori te ngrohte,  
na pa te vetem ne bote.

**A**tehete nje puthje  
permbane te nje mijë pergjigjet  
per pyetjet e dashurise tone,  
deri me sot,  
pastaj heshtja,  
ajo e nje kohe  
qe nuk na braktis me.

**P**laku me geshtenjat e tij,  
ne qoshen e rruges,  
thuajse te shkrete,  
nuk do te bertase me,  
ka mbetur nje vend bosh,  
per te dy.

**D**o doja te te kisha ketu,  
me mua,  
si heren e pare,  
me buzeqeshjen e dashurise,  
shoh ne te kundert,  
disa hije ne fytyren tende.

**E** di qe po pret  
kimeren e fundit

te nje shprese,

qe quhet,

thjesht iluzion.

**B**ote e vetmuar,

e nje kerkimi te larget,

kur mbylla syte,

per t'u kthyer mbrapa ne kohe.

**K**rahet e jetes,

te zgjatura ne pandergjegjesine sepse,

shtrenguan erresiren bosh,

ndersa figura jote kishte ikur,

drejt destinacioneve te reja.

**M**omente te paparashikueshme,

te nje dashurie te gdhendur ne te kaluaren,

*Permes nje xhami*

ne ullishtet,  
shkretetimin e nje stuhie te zymte,  
do te perkule krenarine e atyre pemeve.

**L**utjet e nje gruaje,  
qe ne rete e embla te nje iluzioni,  
sakrifikojne jeten e tyre,  
dhe pyesin veten,  
per fazat e alternuara te nje dite,  
te ndertuar ne reren e se sotmes.

**V**azhdon ky riprezantim,  
ne skenat pafund  
te jetes,  
qe kush na pa proagoniste,  
te nje perralle,  
ne te cilen ke dashur,

*Permes nje xhami*

vetem te improvizosh,  
duke harruar batutat e tekstit.

**E** ardhmja

mbyllet mbi buzet e tua,  
dhe merr nje embelsi,  
te panjohur per mua,  
gjithcka trasformohet,  
nen shenjen e fuqise tende,  
por mbeten shenuar lehte,  
shprehjet e tua te nje kohe.

**E** shkuara,

e harruar nga kush nuk di te kujtoje,  
do te mbeshtjelle,  
permes spiraleve te mjergulles,  
floket e tu,

qe dashuroja te ndjeja mbi fytyren time.

**N**uk do te shkojme me drejt hekurudhes,  
te presim trenin e shpejte te pasdites,  
nuk do te presim me,  
ate lokomotive te zhurmshme,  
si dy femije,  
te rritur shume shpejt.

**N**uk do te kete lule te fushes,  
anes se rruges,  
dimri i ashper do te kete permbytur  
me bore  
edhe gonxhen e fundit.

**D**o te mbeten pleqte,  
ulur prane kishes,

duke menduar per nje mijë gjerat,  
qe do te donin te kishin patur,  
nuk do degjojme,  
atje lart ne mal,  
te bertiturat e te qeshurave tona.

**E**dhe kur autobuzi te zhduket,  
pas ktheses,  
do qendroj vetem duke pyetur pse.

**N**aten rrugicat,  
do kene oret e mia te gjumit,  
do numeroj me te dehurin e perhershem,  
vuajtjen time te dashurise per ty.

**A**tehere,  
do ngjis nje hap,

*Permes nje xhami*

ne shkallen e se nesermes,  
do te numeroj hapat qe na ndajne,  
pellgu i fshehur ne pyll,  
do te zhduket,  
si me magji,  
do te mbeten fantasmat,  
qe jetuan me ne.

**D**o fshijme

gjurmet  
per t'u arratisur bashke,  
por ti,  
do me leshosh doren,  
per te perparuar e vetme,  
kur te kerkosh keto gishta,  
do te gjesh vetem shterpe,

djegur nga dielli.

**N**jeriu i se djeshmes,  
do jete zhdukur,  
per te mos pare mbrapa,  
ndersa te shoqerojne,  
ankthet e tij te harreses.

**N**ga gjemba  
nuk do te sperkase linfa,  
e ekzistences time,  
te tjeret  
do pyesin mes tyre,  
ne c'menyre munde te me duash,  
kaq shume.

**D**o duash te bertasesh,

pa dritten e yjeve,  
edhe toka do te mbylli  
hendeqet e saj,  
do te te braktise  
edhe vdekja,  
vetem,  
me figurat e unit tend,  
imazhe te alternuara,  
te nje historie hipotetike,  
si e jona.

**D**o te kthesh shikimin ne horizont,  
qetesisht,  
do ndjehesh e rrethuar  
nga njeqind hekura,  
nga fati yt,

*Permes nje xhami*

irealiteti i nature,  
kurse,  
ne luften per te ditur,  
do zbulosh cmendurine e dhimbjes.

**B**alona e fantazise,  
do te nise fluturimin e saj te lire,  
si ne nje loje te larget,  
do e ndjekim pas,  
permes vendeve te huaj,  
me shikimin drejt ne qiel.

**N**je ere, e kundert,  
do e shtyje,  
drejt Lindjes,  
me kot,  
do te perpiqemi

ta marrim me vete.

**F**i ja imagjinare,

qe e lidh me doren tende,

do te keputet,

me dhunen

e nje jetë shekullore.

**N**je dite

do te kthehemë me kujtimet,

te flasim per lamtumiren tone,

do pyesim veten ne heshtje,

duke pritur sekondin fatal

te asaj ore.

**D**o vazhdojme

te shenojme ne ajer,

*Permes nje xhami*

gershetime magjike,  
ne vetedijshmerine e se kotes  
te xhesteve toni,  
mundime te nje moshe,  
te lene mes gjerave te vjetra  
te catise,  
kur vraponim te fshiheshim,  
ne dollapin e pluhurosur,  
te braktisur,  
ne nje qoshe te zymte.

**U**lur ne stol,  
ne ate park periferie,  
shoh te lumtur femijet te vrapojne,  
pyes veten  
nese edhe une nje dite,

kam qene si ata.

**K**thehen ne mendje,  
kujtimet e nje te shkuare,  
qe jeton akoma ne te tashmen.

**D**o doja te kisha ndjere  
ate dore,  
mbi koken e vogel,  
te atehershme  
dhe jo fjalet e nje kohe,  
sigurisht jo timen.

**M**e dimrin tek porta  
dhe hunden  
e shtypur mbi xhamin me avull,  
enderr e nje burri,

*Permes nje xhami*

te rritur shume shpejt,  
ne rruge vashdojne te qeshurat  
e nje grupi te vogel,  
te qete,  
isha gati te zbrisja shkallet,  
por gjeta nje porte me shul,  
qe quhet vetmi.

**N**e punen e perhershme,  
me ate xhakete  
konsumuar nga te veshurat e shpeshta,  
pantallonat verore,  
edhe ne mes te vjeshtes,  
beja gjoja sikur s'kishte problem,  
jeta  
nuk i binte kurre ziles

se marrjeve te mia te frymes.

**K**ur me vune

ne fashen e ngushte te drurit,

nuk kisha lene parate

per nje karroce,

te terhequr nga kater kuaj te bardhe,

atethere,

besova,

se isha i harruar nga te gjithe,

edhe nga ty,

por para se toka

te me mbulonte syte,

te pashe,

duke qare,

ne varrin tim te thate.

**L**uaj me dellinjen e fundit,  
para se te kthehem  
ne gjunje,  
ne gjykimin e Judes,  
fajtor i drejte,  
i nje dashurie  
te shperbere ne asgje.

**Q**everis boten,  
kush nuk di te ruaj  
kete fare te keqe,  
bime e dobishme e zemres tende,  
zhgenjyeshem,  
imagjinoj  
histori gjerash te vogla,

duke imituar  
rrahjet e embla te henes.

**E**shte thare,  
edhe burimi i deshires,  
pa e vene re,  
fillova  
te fshij  
kujtimet,  
duke marre ne vete hirin,  
e njeqind turrash druve,  
djegur nga kerkesat e jetes.

**B**uzet  
te ndritura nga nje llampe e larget,  
marrin me vete

*Permes nje xhami*

gjethet e pyjeve te shquar,  
fragmente qe perplasen  
under bykut te asaj anijeje,  
te percaktuar vetem nga nje shkelqim i lehte.

**F**esta eshte afer,  
me perlat kalimtare  
te se nesermes,  
por ererat e ftohta te ndergjegjes,  
do te prishin barrierat  
e njerezve te shkrete.

**N**eser  
nuk do te numeroj me minutat,  
do lexoj ne shikimet futurak,  
fjalet e tua te lamtumires,  
do te shkruaj nje mijë fraza,

te kota,  
si nje femije,  
i frikesuar nga erresira,  
ne kerkim te nje qelli te vrenjtur,  
nga pritja e nje te neserme te ndryshme,  
do te kthej hapat,  
ngadale,  
duke injoruar vleren e kohes.

**K**eshtu vazhdon,  
eshte vetem nje zhurme e shurdhet,  
nje varg i ngadalte i fantazise,  
por jane vetem  
pika uji te erreta,  
qe bien drejt meje.

**S**hume shpesh perqafoj

hijen tende,  
nen ate dritare,  
te mbyllur dhe te erret,  
ne pritje qe te ndizet nje drite,  
pastaj vijoj,  
pa pare mbrapa,  
duke kerkuar mes gureve te rruges,  
nje buzeqeshje te fundit.

**I** terhequr nga kater kuaj te zinj,

do te udheheq ballon  
e iluzionit te fundit,  
deri sa te shoh  
shikimin tend te atehershem.

**N**ga shkembi i kohes,  
do te shfaqet hija  
e nje shqiponje te larget,  
do te flak shigjetat,  
e mprehura,  
me harkun e fildishte,  
te kujtimeve te tua,  
do te zbres,  
ne zonen e shkrete per te pritur  
momentin e luftes.

**D**o te leshohem ne reren e ashper,  
mizore,  
ne kerkim te nje dorezimi te heshtur,  
bishat feline

*Permes nje xhami*

do te me ngulin kthethrat  
ne vithe  
dhe nje gjak i embel do te me mbushe me dashuri.

**D**o te degjosh

lutjet e tingujve memec,

te thate,

ndersa do te kthej,

syte e pergjeruar

drejt mbrojtjes

se atij zoti pagan,

i habitur,

do te shoh,

auroren e perendimit tim.

**K**u kane perfunduar,

ato lote  
te humbur  
ne nje mbremje te ftohte,  
pranvere,  
buzet e tua te dashurise  
me duan akoma me vete,  
perpiqem te kuptoj  
njeqind pyetjet  
qe cdo here kthehen  
te kerkojne  
cmimin e hidhur te jetes sime.

**D**o te ndertoj,  
tulle mbi tulle,  
mbi reren e se nesermes  
premtimet e kujteses,

*Permes nje xhami*

mercenar  
per nje perkedhelje,  
per nje buzeqeshje,  
do te drejtoj hapat e mi,  
duke emigruar nga toka,  
qe me pa foshnje,  
nje supe pa kripe  
do te jete ushqimi,  
i iluzioneve,  
te celura,  
midis gjetheve te nje mimoze delikate.

**M**breti Sers mitik,  
drejtome  
kuroren e komandes,  
pemen e sofres,

*Permes nje xhami*

do te permbyset nga sklleverit e tu,  
mulliri nuk do te bluaje me,  
vreshtat nuk do japin me kokrra ngjyre ari,  
nuk do te ndertojne monumente  
per heronje  
por mbi mal,  
do te murmurisin akoma,  
nostalgjite memece  
te nyjeve te mbeshtjella ne nate.

**R**ete sjellin me vete  
oazin e nje endrre te larget,  
mbrapa  
vegjeton harresa e mendimeve,  
te shkelur nga indiferenca jote.

**H**ijet gjejne

perberjen e tyre

ne fantazine e njerezve,

zjarri digjet

dhe ne zjarrin

e fshatit,

humba parajsen e fundit

per te ardhur drejt teje,

mbetur midis duarve te mia.

**A**tehere,

do te kthehem te lodhur,

perkulur nga dhimbja,

pa gjetur me forceen per t'u ringritur,

ndersa do te skicoen ne qiel,

linjat e nje dashurie te pamundur.

**D**eget e thata te se shkuares

do te mohojne

kete mbreteri tonen,

do te na bejne me faj

per lindjen e diellit,

nje ngjitje e shpejte drejt te panjohures

dhe do te zbulojme ngjashmerite perjetesore

te shtegut ekstrem.

**M**brapa shtepise,

paqen e nje historie te shkuar,

kete mbremje do te dhuroj,

duke mbyllur syte.

**D**o te jene endrrat e perhershme

*Permes nje xhami*

qe do largohen nga une,  
ne heshtje,  
si dikur,  
shpesh shpikim fjale,  
duke pritur dritten e nje se neserme  
qe nuk do te vije kurre.

**M**brapa asaj shtepie,  
do te genjej veten sikur do kthehem femi,  
do filloj te vrapij neper fusha,  
te ndjek  
nje mijë fluturat e urejtjes,  
duke vazhduar te te dua,  
duke numeruar keshtu minutat.

**I**sha mes te tjereve,  
nje fytyre,

*Permes nje xhami*

fatkeqsisht, anonime,  
ai veshtrim,  
i hedhur ne horizont,  
kisha nevoje te krijoja nje shpirt,  
per jeten time,  
kisha deshire te besoja  
ne nje Zot,  
per ta shkaterruar me pas.

*Permes nje xhami*

Te drejtat i rezervohen

Shtepise botuese elektronike Liber Iter

Ndalohet riprodhimi i vepres ne cdo lloj formati, forme  
dhe transmetim te dhenash, denohet ne baze te ligjit si  
pasoje e rregjistrimit te vetem dhe personal

Publikuar ne 2011


nga

Liber iter

Edizioni elettroniche

ISBN 978-88-96705-61-2

*Permes nje xhami*



## Publikime te tjera ne site

### Nga i njejti autor:

*Le dolci illusioni*, Michele Cénnamo, 2010,  
<http://www.liberiter.it/?p=314>

### Ne te njejten gjuhe:

*Sekretet e piktures dhe tregut te saj*, Leonardo Echeoni, 2010,  
<http://www.liberiter.it/?p=286>

## **LICENCE PERDORIMI**

***Bleresi i nje teksti ne format elektronik impenjohet ne respektimin e kushteve qe vijojne:***

- 1.** Permbajtja e librit i perket ekskluzivisht autorit dhe nuk mund te shperndahet teresisht apo pjeserisht ne emer tjeter.
- 2.** Kopja qe i deroghet bleresit duhet te qendroje e vetme dhe nuk mund per asgne arsyre dhe ne asgne menyre te riprodhohet, shumfishohet dhe transmetohet personave te trete pa lejen e shtepise botuese e cila eshte pronare e saj.
- 3.** Ndaloher shperndarja nepermjet kopjeve te shtypura.
- 4.** Leximi i pdf i lejohet vetem bleresit te licences, i cili pas blerjes mund ta perdore ne jo me teper se tre dispositivo elektronik per lexim, dhe te cilet jane prone personale
- 5.** Nuk lejohet kalimi i tekstit elektronik ne suporte informatike, prone e personave te trete.
- 6.** Ndaloher cdo lloj forme riprodhimi (edhe nepermjet email apo fax), dhenja publikut, shperndarja, shitja dhe cdo lloj tjeter menyre per perdom ekonomik apo moral te cilat i rezervohen vetem pronarit te librit.